

## Hilda Biobank Freiburg Informacione për pacientët pas arritjes së moshës madhore

për dhurimin, ruajtjen dhe përdorimin e materialeve bio si dhe për mbledhjen, përpunimin dhe përdorimin e të dhënave për qëllime shkencore

I(e) nderuar pacient(e),

po ju drejtohem sot sepse keni mbushur së fundmi 18 vjeç dhe si rrjedhojë jeni në moshën madhore.

Në të kaluarën iu ishte marrë mostra të materialit e cila ruhej në Hilda Biobank Freiburg kur ishit të mitur, si pjesë e testeve diagnostikuese. Pëlqimin tuaj për të marrë pjesë në Hilda Biobank Freiburg në atë kohë e konfirmuan prindërit tuaj, pasi pëlqimi për të miturit kërkohej nga kujdestari ligjor. Pasi tashmë keni arritur moshën madhore duhet të vendosni vetë se si do të përdoren mostra të materialit dhe të dhënat tuaja.

Për të marrë këtë vendim, dëshirojmë t'ju informojmë gjerësisht në lidhje me Hilda Biobank Freiburg. Në vijim për këtë do të merrni informacione me shkrim ndërsa mjeku juaj do t'ju informojë për biobankën gjatë një bisede me të. Për pyetje mund të kontaktoni personin kontaktues, i përmendur në faqen 1 të fletëpalosjes informative. Pjesëmarrja juaj në Hilda Biobank është vullnetare dhe ju mund të tërhiqni pëlqimin tuaj pa dhënë arsye dhe pa pasur asnjë disavantazh për trajtimin tuaj mjekësor.

Ne ju kërkojmë të mbështesni Hilda Biobank Freiburg dhe të vazhdoni të na jepni mostra të materialit dhe të dhënat tuaja për projekte hulumtuese mjekësore. Nëse dëshironi të pranoni të merrni pjesë, ju lutemi nënshkruani mëposhtë deklaratën e pëlqimit e Hilda Biobank Freiburg. Nëse nuk dëshironi që mostrat e materialit tuaj vazhdojnë të ruhen në biobankë, ju lutemi na njoftoni për këtë. Mostrat e ruajtura tashmë në biobankë do të hidhen më pas dhe të dhënat përkatëse do të fshihen. Ju lutemi vini re se mostrat që janë përdorur tashmë në projekte hulumtuese ose të dhënat që janë përfshirë në vlerësime nuk mund të hidhen/fshihen më.

Ju falënderojmë paraprakisht për interesimin tuaj në Hilda Biobank Freiburg dhe mirëpresim mbështetjen tuaj.

Përshëndetje të përzemërta,

Brigitte Strahm  
Head of the Biobank  
Hilda Biobank Freiburg at the Kinder- und Jugendklinik